



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

[www.qbz.gov.al](http://www.qbz.gov.al)

**Nr. 179**

**11 nëntor**

**2013**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Udhëzim i MEI nr. 1, datë 30.10.2013	Për rregullat dhe procedurat e shqyrtimit të aplikimeve për marrjen e lejeve ndërtimore për objekte të natyrës energjetike, minerare, industriale dhe objekte me rrezikshmëri të lartë të kësaj fushe, si dhe për ngritjen e komisionit për shqyrtimin e kërkesave për dhënie të këtyre lejeve.....	7647
Vendim i GJL nr. 3, datë 29.3.2012	Me objekt shpërblim dëmi dhe ndalim i ushtrimit të aktivitetit në kushtet e konkurrencës së pandershme.....	7652

**UDHËZIM**  
**Nr. 1, datë 30.10.2013**

**PËR RREGULLAT DHE PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË APLIKIMEVE PËR  
MARRJEN E LEJEVE NDËRTIMORE PËR OBJEKTE TË NATYRËS ENERGJETIKE,  
MINERARE, INDUSTRIALE DHE OBJEKTE ME RREZIKSHMËRI TË LARTË TË KËSAJ  
FUSHE, SI DHE PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE  
PËR DHËNIEN E KËTYRE LEJEVE**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 1/b të nenit 72, pikës 2 të nenit 76, nenit 78 dhe nenit 79 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, nenit 8, nenit 10, nenit 13 dhe nenit 14 të ligjit nr. 110/2013, miratuar në datën 1.4.2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, si dhe të nenit 11, pikës 1/b të nenit 12, nenit 16 dhe nenit 18 të vendimit nr. 502, datë 13.7.2011 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit”, të ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

1. Trajtimi dhe përpunimi paraprak i kërkesës së subjektit që paraqet në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) një aplikim për marrje leje për punime ndërtimore objektsh të natyrës energjetike, minerare, industriale dhe objekte me rrezikshmëri të lartë të kësaj fushe, bëhet nga njësia përkatëse në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, që mbulon fushën e aktivitetit, për objektet për të cilat është paraqitur kërkesa dhe aplikimi përkatës, pasi më parë nga ana e subjektit të jetë bërë pagesa për “tarifën e aplikimit” (e përcaktuar në përmbushje të kërkesës së germës “C”, seksioni 8, i formularit TIP 1 “Kërkesë për kryerje punimesh”, shtojca 2 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 502, datë 13.7.2011 “Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, “Fatura e pagesës për tarifën e aplikimit”).

Vlera e tarifës së aplikimit është 150 000 lekë, pavarësisht nga lloji i objektit të natyrës energjetike apo i objektit me rrezikshmëri të lartë të kësaj fushe, për të cilën kërkohet leja për punime ndërtimore.

2. Për shqyrtimin e kërkesave dhe të aplikimeve përkatëse, për dhënie leje për ndërtim dhe shfrytëzim objektsh të natyrës energjetike, minerare, industriale dhe objekteve me rrezikshmëri të lartë të kësaj fushe, ngrihet “Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për dhënie leje për ndërtim dhe shfrytëzim objektsh të natyrës energjetike, minerare, industriale dhe objekte me rrezikshmëri të lartë të kësaj fushe”, me përbërje si më poshtë:

- Kryetar:	- Sekretari i Përgjithshëm i MEI	
- Anëtarë:	- Drejtoria e Politikave të Zhvillimit të Hidrokarbureve	2 (dy)
	- Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Elektroenergjetik	2 (dy)
	- Drejtoria e Politikave të Zhvillimit të Minierave	1 (një)
	- Drejtoria e Politikave të Zhvillimit të Industrisë dhe Standardeve Teknike	2 (dy)
	- Drejtoria Juridike	1 (një)
	- Kabineti i Ministrit	1 (një)
	- Albpetrol sh.a. (specialist teknolog, specialist ndërtimi)	2 (dy)
	- KESH sh.a. (specialist energjetik)	1 (një)
	- AKBN (specialist mjedisi)	1 (një)
	- SHGJSH (specialist gjeolog inxhinierik)	1 (një)



Përcaktimi i emrave në përbërje të “Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për dhënie leje për ndërtim dhe shfrytëzim objektesh të natyrës energjetike, minerare, industriale dhe objekte me rrezikshmëri të lartë të kësaj fushe”, bëhet nëpërmjet një urdhri të kryetarit të Komisionit, mbi bazën e propozimeve nga drejtoritë dhe institucionet përkatëse.

Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për dhënie leje për ndërtim dhe shfrytëzim objektesh të natyrës energjetike, minerare, industriale dhe objekte me rrezikshmëri të lartë të kësaj fushe, mbledhet me kërkesë të kryetarit, sa herë që kërkohet shqyrtimi i praktikave për dhënie leje për punime në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar.

Në njoftimin e dhënë nga kryetari, jepet edhe agjenda e mbledhjes së Komisionit, si dhe vendi, data dhe ora e zhvillimit të mbledhjes.

Mbledhja e Komisionit zhvillohet vetëm në rast se janë prezentë më shumë se 2/3 e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Komisionit.

Kryetari i Komisionit cakton një person në rolin e sekretarit të këtij Komisioni.

3. Për çdo aplikim të paraqitur në MEI për marrje leje për punime ndërtimore për objekte të natyrës energjetike, minerare, industriale dhe objekte me rrezikshmëri të lartë të kësaj fushe, njësia e MEI-t, që mbulon fushën e aktivitetit energjetik, mineral ose industrial përkatës, për objektet për të cilat është paraqitur kërkesa dhe aplikimi nga subjekti i interesuar për marrje leje për punime ndërtimore, brenda 5 (pesë) ditëve pune bën verifikimin e përmbushjes në formë të kërkesave për dokumentacionin e paraqitur nga subjekti aplikues.

Pjesë e dokumentacionit të dorëzuar nga aplikuesi për marrje leje për punime ndërtimore duhet të jetë edhe dokumenti i planit të vendosjes së ndërtimit, i cili duhet të jetë i miratuar paraprakisht nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore që ka nën juridiksion zonën e vendndodhjes së strukturës që do të ndërtohet. Plani i vendosjes së ndërtimit përmban planin e vendosjes së strukturës ndërtimore, lidhjen e strukturës me infrastrukturën në zonë, si dhe pozicionin e saj në kuadër të planit të miratuar (në rast se ekzistenca e këtij plani është kërkesë e planifikimit të integruar).

Nëse dokumentacioni nuk është i plotë, subjekti njoftohet duke i lënë një afat 30-ditor për plotësimin e mangësive.

Nëse dokumentacioni është i plotë, për kërkesën dhe dokumentacionin shoqërues të këtij aplikimi, nëpërmjet kryetarit të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për dhënie leje për ndërtim dhe shfrytëzim objektesh të natyrës energjetike, minerare, industriale dhe objekte me rrezikshmëri të lartë të kësaj fushe, përcillet njoftim në Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT) për vlerësim dhe pasqyrim në regjistër, si dhe përcillet kërkesa për marrje mendimi oponent nga institucione ose ekspertë të fushës.

4. Njësia përkatëse në MEI, që mbulon fushën e aktivitetit energjetik, mineral, industrial përkatës, për objektet për të cilat është paraqitur kërkesa dhe aplikimi përkatës për marrje leje për punime ndërtimore, me miratim të kryetarit të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për dhënie leje për ndërtim dhe shfrytëzim objektesh të natyrës energjetike, minerare, industriale dhe objekte me rrezikshmëri të lartë të kësaj fushe, bën afishimin në faqen zyrtare të *web* të MEI-t të njoftimit për kërkesën dhe aplikimin e paraqitur për marrje leje për punime ndërtimore, duke lënë një afat 10 ditë për shprehje të vërejtjeve, propozimeve ose pretendimeve për këtë aplikim, nga çdo autoritet kombëtar dhe/ose vendor i interesuar, si dhe palë e interesuar për aplikimin.

5. Përgatitja e dosjes, si dhe e raportit shoqërues për përmbushjen në formë të kërkesave të aplikimit, të cilat do të paraqiten në Komision, bëhen nga njësia e MEI-t, që mbulon fushën e aktivitetit energjetik, mineral ose industrial përkatës, për objektet për të cilat është paraqitur kërkesa dhe aplikimi nga subjekti i interesuar për marrje leje për punime ndërtimore, pasi për këtë aplikim të jetë marrë mendimi oponent nga institucione ose ekspertë të fushës.

Kopja e dokumentit të planit të vendosjes së ndërtimit, që përmban planin e vendosjes së strukturës ndërtimore, lidhjen e strukturës me infrastrukturën në zonë, si dhe pozicionin e saj në kuadër të planit territorial (në rast se ekzistenca e këtij plani është kërkesë e planifikimit të integruar), azhurnohet nga sektori/eksperti i GIS në përbërje ose vartësi të MEI-t.

6. Vlerësimi i MEI-t për dhënien e lejes për punime ndërtimore të natyrës energjetike, minerare, industriale dhe objekte me rrezikshmëri të lartë të kësaj fushe (sipas llojit të lejes/lejeve, sikurse është kërkuar nga subjekti aplikues), i përgatitur nga ana e njësisë së MEI-t, që ka trajtuar aplikimin e subjektit për marrje leje për punime, si dhe dokumenti i planit të vendosjes së ndërtimit, që përmban planin e vendosjes së strukturës ndërtimore, lidhjen e strukturës me infrastrukturën në zonë, si dhe pozicionin e saj në kuadër të planit të miratuar (në rast se ekzistenca e këtij plani është kërkesë e instrumentit të planifikimit), janë pjesë e dosjes që bashkëshoqëron praktikën që dorëzohet në Komisionin, duke vënë në dijeni kryetarin e Komisionit.

7. Mbledhja e Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për dhënie leje për ndërtim dhe shfrytëzim objektiv të natyrës energjetike, minerare, industriale dhe objekte me rrezikshmëri të lartë të kësaj fushe, bëhet jo më vonë se 10 ditë nga paraqitja e dosjes me të gjitha materialet dhe dokumentacionin përkatës që lidhen dhe janë në plotësim të kërkesës së paraqitur nga subjekti për marrjen e lejes për punime ndërtimi, përfshirë edhe marrjen e mendimit oponent nga institucione ose ekspertë të fushës.

8. Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për dhënie leje për ndërtim dhe shfrytëzim objektiv të natyrës energjetike, minerare, industriale dhe objekte me rrezikshmëri të lartë në këtë fushë, bën trajtimin e çështjeve si më poshtë:

a) Shqyrton kërkesat për dhënie leje për ndërtim dhe shfrytëzim objektiv të natyrës energjetike minerare, industriale dhe objekte me rrezikshmëri të lartë të kësaj fushe, duke bërë:

i) kontrollin e rregullshmërisë nga pikëpamja teknike të dokumentacionit që shoqëron aplikimin;

ii) vlerësimin e përputhshmërisë për leje për punime ndërtimi me instrumentet e planifikimit, mbi bazën e praktikave dhe të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga njësi përkatëse në MEI, që mbulon fushën e aktivitetit energjetik, mineral ose industrial përkatës, për objektet për të cilat është paraqitur kërkesa dhe aplikimi përkatës për marrje leje për punime ndërtimore.

b) Mbi bazën e vlerësimit nga anëtarët e Komisionit, si dhe duke pasur në konsideratë edhe mendimin oponent nga institucione ose ekspertë të fushës, Komisioni merr vendimin për:

i) praninë të kërkesës dhe aplikimit përkatës dhe për paraqitjen për miratim të ministrit të vlerësimit që do të japë MEI lidhur me dhënien e lejes për punime ndërtimi, sipas llojit të lejes/lejeve, sikurse është kërkuar nga subjekti aplikues, si dhe të dokumentit të planit të vendosjes së ndërtimit, që përmban planin e vendosjes së strukturës ndërtimore, lidhjen e strukturës me infrastrukturën në zonë, si dhe pozicionin e saj në kuadër të planit të miratuar (në rast se ekzistenca e këtij plani është kërkesë e instrumentit të planifikimit) të firmosur paraprakisht nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore që ka nën juridiksion zonën e vendndodhjes së strukturës që do të ndërtohet.

Kërkesa dhe aplikimi përkatës, shoqëruar me vlerësimin e MEI-t lidhur me dhënien e lejes për punime ndërtimi, sipas llojit të lejes/lejeve përcillen në AKPT për procedim të mëtejshëm për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT);

ii) refuzim të kërkesës dhe aplikimit përkatës, duke paraqitur të ministrit informacionin me argumentet përkatëse për shkaqet e refuzimit të dhënies së lejes për punime ndërtimi.

Komisioni merr vendim me shumicë votash.

9. Për çdo kërkesë që shqyrtohet, Komisioni harton procesverbalin përkatës, i cili duhet të firmoset nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës në mbledhje.



10. Anëtarët e Komisionit për çdo mbledhje do të paguhen me 10 mijë lekë, kryetari me 15 mijë lekë, ndërsa sekretari do të paguhet me 5 mijë lekë. Ky shpërblim do të sigurohet nga të ardhurat e MEI-t.

11. Në rast refuzimi të kërkesës dhe aplikimit përkatës për procedim të mëtejshëm për marrje leje për ndërtim dhe shfrytëzim objektsh të natyrës energjetike, minerare, industriale dhe objekte me rrezikshmëri të lartë në këtë fushë, njoftohet subjekti aplikues duke dhënë edhe argumentet përkatëse për shkaqet e refuzimit sipas kërkesës së paraqitur.

12. Subjekti ka të drejtë që brenda një afati 30-ditor të bëjë plotësim të mangësive të vërejtura nga Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për dhënie leje për ndërtim dhe shfrytëzim objektsh të natyrës energjetike, minerare, industriale dhe objekte me rrezikshmëri të lartë në këtë fushë, si dhe/ose të paraqesë materiale plotësuese dhe sqaruese për aplikimin e paraqitur.

Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për dhënie leje për ndërtim dhe shfrytëzim objektsh të natyrës energjetike, minerare, industriale dhe objekte me rrezikshmëri të lartë në këtë fushë, mbi bazën e një raporti plotësues të përgatitur nga njësia e MEI-t, që mbulon fushën e aktivitetit energjetik, mineral ose industrial përkatës, për objektet për të cilat është paraqitur kërkesa dhe aplikimi përkatës për marrje leje për punime ndërtimore, brenda një periudhe 15-ditore, rishqyrton aplikimin e paraqitur dhe merr vendimin përkatës.

Në rast pranimit të kërkesës dhe aplikimit të riparaqitur nga subjekti i interesuar, Komisioni, në përputhje me procedurën e përshkruar në pikën 8 më sipër, paraqet te ministri për miratim dokumentacionin përkatës të vlerësimit të MEI-t për dhënien e lejes për punime ndërtimi, sipas llojit të lejes/lejeve, sikurse është kërkuar nga subjekti aplikues.

Në rast refuzimi për herë të dytë të procedimit për dhënien e lejes për punime ndërtimi, sipas kërkesës së paraqitur, subjekti ka të drejtë të paraqesë kërkesë ankimore në organet gjyqësore.

13. Njësia përkatëse që ka trajtuar aplikimin e subjektit për marrje lejeje për punime ndërtimore, përgatit praktikën për dërgim në AKPT:

a) një kopje të vlerësimit të MEI-t për procedimin e mëtejshëm për shqyrtim dhe miratim në KKT të aplikimit për dhënien e lejes për punime ndërtimi të firmosur nga ministri; si dhe

b) një kopje të firmosur nga ministri të dokumentit të planit të vendosjes së ndërtimit, që përmban planin e vendosjes së strukturës ndërtimore, lidhjen e strukturës me infrastrukturën në zonë, si dhe pozicionin e saj në kuadër të planit të miratuar (në rast se ekzistenca e këtij plani është kërkesë e instrumentit të planifikimit), të firmosur nga ministri dhe kryetari i njësisë së qeverisjes vendore që ka nën juridiksion zonën e vendndodhjes së strukturës që do të ndërtohet.

14. Pas dërgimit në MEI nga ana e AKPT-së të vendimit përkatës të KKT-së për miratimin e lejes për punime ndërtimore për ndërtim dhe shfrytëzim objektsh të natyrës energjetike, minerare, industriale dhe objekte me rrezikshmëri të lartë në këtë fushë, njësia e MEI-t që mbulon aktivitetin energjetik, mineral ose industrial përkatës, përgatit dokumentin administrativ teknik për zbardhjen e lejes së dhënë nga KKT-ja (referuar formularit TIP 3 ose formularit TIP 5, shtojca 2 e vendimit nr. 502, datë 13.7.2011 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit”, të ndryshuar).

Dokumenti administrativ teknik firmoset nga ministri në dy kopje origjinale.

Njësia e MEI-t që mbulon aktivitetin energjetik, mineral ose industrial përkatës, nëpërmjet zyrës së protokollit të MEI-t, i dorëzon përfaqësuesit ligjor të subjektit aplikues apo të autorizuarit të tij, një kopje origjinale të firmosur të dokumentit administrativ teknik që i referohet vendimit të KKT-së për miratimin e lejes për punime ndërtimore për ndërtim dhe shfrytëzim objektsh të natyrës energjetike, minerare, industriale dhe objekte me rrezikshmëri të lartë në këtë fushë.

15. Në përfundim të punimeve të ndërtimit, të kryera në përputhje me lejen/lejet e dhëna, sipas këtij udhëzimi për punime ndërtimi, mbi bazën e një kërkesë të paraqitur nga subjekti i pajisur me leje, e cila shoqërohet me dokumentacionin përkatës që vërteton respektimin e kushteve të lejes/lejeve, lëshohet “leja e përdorimit”.

Njësia e MEI-t, që mbulon fushën e aktivitetit energjetik, mineral ose industrial përkatës, për objektet për të cilat është dhënë nga KKT-ja leja për punime ndërtimore, përgatit “vërtetimin e përputhshmërisë”, referuar akteve të kontrollit që vërtetojnë realizimin e punimeve në përputhje me kushtet e lejes, sipas fazave të përcaktuara në rregulloret e kontrollit të zhvillimit. Mbi bazën e “vërtetimit të përputhshmërisë”, si dhe të dokumentacionit shoqërues, ministri lëshon “lejen e përdorimit” për objektin e ndërtuar.

Leja e përdorimit botohet në regjistrin e planifikimit të territorit.

Në rast refuzimi të lejes së përdorimit, në zbatim të pikës 4 të nenit 79 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, lëshohet akti i konstatimit të mospërputhshmërisë, i cili në pjesën e arsytimit u referohet dokumenteve të akteve të kontrollit.

16. Njësia përkatëse që ka trajtuar kërkesën e subjektit për marrje leje përdorimi, nëpërmjet zyrës së protokollit në MEI, i dorëzon përfaqësuesit ligjor të subjektit aplikues apo të autorizuarit të tij një kopje origjinale të dokumentit të “lejes së përdorimit” të firmosur nga ministri.

Zyra e protokollit në MEI mban në dosjen e dokumentacionit të subjektit aplikues, një kopje origjinale të dokumentit të lejes së përdorimit të firmosur nga ministri.

17. Ngarkohet Drejtoria e Financës për planifikimin në buxhetin e MEI-t të shpenzimeve të nevojshme për pagesën e anëtarëve të komisionit për shqyrtimin e kërkesave për dhënie leje për ndërtim dhe shfrytëzim objektsh të natyrës energjetike, minerare, industriale dhe objekte me rrezikshmëri të lartë në këtë fushë.

18. Udhëzimi nr. 1, datë 30.4.2012 i ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës “Për rregullat dhe procedurat e shqyrtimit të aplikimeve për marrjen e lejeve ndërtimore për objekte të natyrës energjetike dhe objekte me rrezikshmëri të lartë të kësaj fushe, si dhe për ngritjen e Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për dhënien e këtyre lejeve”, i ndryshuar, shfuqizohet.

19. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen njësitë e MEI-t, që mbulojnë aktivitetin energjetik, mineral ose industrial përkatës, si dhe Drejtoria Juridike.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë, shpallet në faqen zyrtare *web* të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ENERGJISË DHE INDUSTRIË  
**Damian Gjijnuri**



**VENDIM**  
**Nr. 3, datë 29.3.2012**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbëra nga:

Besnik Imeraj	kryesues
Gani Dizdari	anëtar
Ardian Dvorani	anëtar
Fatos Lulo	anëtar
Ardian Nuni	anëtar
Arjana Fullani	anëtare
Majlinda Andrea	anëtare
Guxim Zenelaj	anëtar
Aleksandër Muskaj	anëtar
Andi Çeliku	anëtar
Evelina Qirjako	anëtare
Mirela Fana	anëtare
Medi Bici	anëtar
Edmond Islamaj	anëtar
Shkëlzen Selimi	anëtar

në seancën gjyqësore të datës 29.3.2012, morën në shqyrtim çështjen civile që i përket:

**PADITËSE:** Silvana Miho

**I PADITUR:** Panajot Barka

**PERSONA TË TRETË:** Enti Rregullator i Telekomunikacioneve  
Dega e Tatim-Taksave Gjirokastrë

**OBJEKTI I PADISË:** Shpërblim dëmi dhe ndalim i ushtrimit të aktivitetit në kushtet e konkurrencës së pandershme.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 638/3 dhe 639 të Kodit Civil. Neni 32 i K.Pr.Civile.

**Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë**, me vendimin nr. 210, datë 9.3.2007, ka vendosur:

*Rrëzimin e padisë së paditëses Silvana Miho.*

**Gjykata e Apelit Gjirokastrë**, me vendimin nr. 213, datë 30.5.2007, ka vendosur:

*Lënien në fuqi të vendimit nr. 210, datë 9.3.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.*

Kundër vendimit të gjykatës së apelit ka ushtruar rekurs paditësja Silvana Miho, me të cilin kërkon prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pranimin e padisë, për këto shkaqe:

- Vendimet e gjykatave janë marrë në zbatim të gabuar të ligjit dhe në kundërshtim të hapur me të dhe me provat e administruara në gjykim.

- Kemi provuar se paditësja ushtron aktivitet privat konform ligjeve. Fusha e aktivitetit të paditëses është cenuar nga i padituri, i cili ka ushtruar të njëjtin aktivitet në kundërshtim me ligjin.

- Arsytimi i vendimeve është alogjik dhe në kundërshtim të hapur me provat dhe me atë që është kërkuar nga paditësja.

- Gjykata konstaton se nga ana e të paditurit janë kryer veprime në kundërshtim me ligjin, që rregullojnë aktivitetin privat që ushtroj dhe jam cenuar, por gjykata nuk zgjidhi pasojat e këtij cenimi, duke mos vendosur dëmshpërblimin.

- Nga ana e gjykatave pranohet fakti se i padituri ka ushtruar veprimtari pa licencë, në kundërshtim me ligjin, por sipas tyre kjo nuk përbën provë që i padituri ka vepruar me faj dhe nuk provohet lidhja shkakësore.

- Konkluzioni i gjykatave që veprimtaria që unë ushtroj nuk mbrohet nga ligji nr. 9121, datë 28.7.2003 është i gabuar, sepse veprimtaria që ushtroj, provajder interneti, është veprimtari shërbimi, dhe si e tillë ajo përfshihet në nenet 2/1, 3/1, 3/3 të këtij ligji.

- Nga ana e gjykatës nuk u hetua fare fakti se djali i të paditurit në vitin 2004 vodhi pajisjet e punës sime, për të cilën është dënuar dhe penalisht.

- Sipas nenit 638/3 të Kodit Civil veprimet e konkurrencës mund të jenë çdo mjet tjetër i përdorur, që nuk përputhet me parimet e ndershmërisë profesionale, ndërkohë që neni 639 parashikon shpërblimin e dëmit kur veprimet e të paditurit janë me faj.

- Argumenti i gjykatës se nuk u provua fajësia e të paditurit është i gabuar dhe i qëllimshëm, pasi që në momentin që ERRT-ja bëri kontrollin dhe konstatoi aktivitet të paligjshëm të të paditurit dhe urdhëroi mbylljen e tij vërtetohet fajësia e të paditurit.

- Në lidhje me masën e dëmit të ardhur, kur vetë gjykata e apelit shprehet se nuk mund të konkludohet lidhur me shkaqet e luajtjes së xhiros, mund dhe duhet të ishte bërë akt i ri ekspertimi.

**Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë**, në seancën e datës 1.2.2011, ka vendosur dërgimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për unifikim të praktikës gjyqësore.

Kolegji Civil, për efekt të njësimin të praktikës gjyqësore, ka parashtruar para Kolegjeve të Bashkuara për të mbajtur qëndrim në lidhje me pyetjen vijuese:

*- Cili është roli që duhet të luajë gjykata, veçanërisht në procesin e identifikimit të objektit të mosmarrëveshjes që duhet të shqyrtojë dhe të zgjidhë, pa cenuar të drejtën e disponimit të palëve që e kanë vënë atë në lëvizje?*

*- A duhet të lidhet përgatitja dhe më pas gjykimi e zgjidhja e çështjes vetëm mbi atë që formalisht shkruhet dhe që në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë emetohen si “objekt i padisë” dhe “baza ligjore”?*

#### KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjuan relatimin e çështjes nga gjyqtarët Mirela Fana dhe Edmond Islamaj; përfaqësuesin me prokurë të palës paditëse, i cili parashtroi se jemi dakord me gjykimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuara; në mungesë të palës së paditur; dhe pasi e biseduan çështjen në tërësi,

#### VËREJNË:

##### **A. Rrethanat e çështjes**

1. Paditësja Silvana Miho është regjistruar si person fizik me vendimin nr. 21, datë 27.1.2003 të Gjykatës dhe pranë Degës së Tatimeve Gjirokastër, me NIPT K32508662F, për ushtrim aktiviteti privat “shërbim interneti” në qytetin e Gjirokastrës. Në datën 16.9.2005 paditësja është pajisur me licencën përkatëse nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve, duke u përcaktuar dhe kushtet specifike të ushtrimit të këtij aktiviteti.

2. Nga ana tjetër, i padituri Panajot Barka ofron shërbim interneti në qytetin e Gjirokastrës.

3. Mbi ankimin e paditëses, Enti Rregullator i Telekomunikacioneve ka inspektuar subjektin Panajot Barka në datën 7.4.2006 dhe ka konstatuar se i padituri Panajot Barka ofronte shërbim interneti, për të cilin ishte regjistruar në Degën e Tatimeve Gjirokastër, me NIPT K35121605V, por nuk ishte pajisur me licencë nga Enti Rregullator. Për mungesë të licencës grupi i inspektimit i ka ndërprerë përdorimin e stacionit satelitor deri në pajisjen me të. I padituri Panajot Barka është pajisur me licencën përkatëse në datën 9.6.2006, në të cilën janë përcaktuar dhe kushtet specifike të shfrytëzimit të licencës.

4. Paditësja Silvana Miho, me pretendimin se i padituri Panajot Barka për periudhën që ka kryer aktivitet privat, shërbim interneti i papajisur me licencë nga ERT-ja, si rezultat i konkurrencës





së pandershme, i ka shkaktuar një dëm ekonomik, me padinë e datës 25.9.2006, bazuar në nenet 638/3 dhe 639 të K. Civil, ka kërkuar shpërblimin e dëmit të shkaktuar dhe ndalimin e aktivitetit.

#### **B. Procedura gjyqësore**

1. **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë**, me vendimin nr. 210, datë 9.3.2007, ka vendosur: *Rrëzimin e padisë së paditëses Silvana Miho.*

2. **Gjykata e Apelit Gjyqësor Gjirokastrë**, me vendimin nr. 213, datë 30.5.2007, ka vendosur: *Lënien në fuqi të vendimit nr. 210, datë 9.3.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.*

3. Kundër vendimit të gjykatës së apelit ka ushtruar rekurs paditësja Silvana Miho, me të cilin kërkon prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pranimin e padisë, duke parashtruar edhe shkaqet përkatëse të pasqyruara në pjesën hyrëse të vendimit.

4. **Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë**, në seancën e datës 1.2.2011, ka vendosur dërgimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për unifikim të praktikës gjyqësore, duke parashtruar dhe pyetjet e cituara më lart në këtë vendim.

#### **C. Arsyetimi gjyqësor i vendimeve të gjykatave**

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, arsyeton se:

Gjykata, pasi citon nenet 638/3, 639, 608 të K. Civil, arsyeton: “... *pavarësisht mungesës së një përkufizimi ligjor në lidhje me sferën e veprimeve që përbëjnë konkurrencë të pandershme, nocioni i konkurrencës së pandershme duhet parë i lidhur ngushtësisht me dispozitat që kanë lidhje me mbrojtjen e shenjave dalluese dhe të drejtave të patentës. Rregullat përcaktohen nga ligji ... “Për pronësinë industriale”. Nga shqyrtimi gjyqësor, rezultoi se paditësja nuk i ka bazuar kërkimet e saj në dispozitat e këtij ligji dhe, edhe lloji i aktivitetit që ajo ushtron është jashtë mbrojtjes së këtij ligji”, nga ana tjetër nuk rezultoi e provuar që paditësja të ketë të regjistruar ndonjë markë shërbimi apo të jetë poseduese e ndonjë patente industriale për këtë qëllim. “Përkundrajt mungesës së këtyre elementeve, aktiviteti i paditëses, ... përbën thjesht një veprimtari të një biznesi të vogël dhe që kurrsesi nuk mund të përfshihet në kategorinë e atyre shoqërive tregtare që për shkak të transaksioneve të mëdha financiare që realizojnë, risive që paraqesin dhe pozitës së tyre dominuese në treg, mund të pretendojnë për veprime të konkurrencës së pandershme nga subjekte të tjera të po kësaj kategorie në treg”; - Në lidhje me pretendimin për dëmin e shkaktuar “... nuk rezultoi i provuar në këtë drejtim përgjegjësia civile e të paditurit për shkak të mungesës së elementeve të kësaj përgjegjësie”, “nga përmbajtja e aktit të ekspertimit ... nuk rezultoi që paditësja të kishte pësuar ndonjë dëm konkret për periudhën kohore gjatë së cilës, ajo ka ofruar në mënyrë të licencuar shërbimin e internetit në qytetin e Gjirokastrës. Diferenca, që ekzistonte ..., midis xhiros vjetore të planifikuar nga paditësja dhe xhiros së realizuar nga ajo për vitin 2005, të pretenduar ... si dëm ekonomik, u konsiderua nga eksperti ... si një fenomen normal në kushtet e ekonomisë së tregut, si pasojë e veprimit të faktorëve të shumtë specifikë dhe që kurrsesi nuk mund të përbëjë dëm në kuptimin ekonomik ...”; - “Për sa u përket nocioneve të emrit të mirë dhe të humbjes së klientelës ..., eksperti ..., u shpreh se këto koncepte ishin privilegje të kompanive që prodhojnë dhe hedhin në treg sinjalet e internetit dhe jo të shpërndarësve të këtyre sinjaleve pranë çdo klienti, në kategorinë e të cilëve bën pjesë edhe subjekti Silvana Miho”; - në lidhje me veprimet e të paditurit, nuk u provua ndonjë veprim i paligjshëm që t’i shkaktonte dëm aktivitetit të paditëses; ofrimi i shërbimit nga ana e të paditurit nga dhjetori i 2005-ës deri më 16.9.2005, përbën një veprim të kryer në kundërshtim me nenin 47 të ligjit për telekomunikacionet, por nuk ka pasur ndikim në aktivitetin e paditëses; mungesa e licencës përbën aspekt kundërligjshëm në drejtim të respektimit të menaxhimit të veprimtarisë së telekomunikacioneve, që sipas neneve 92 dhe 93 ndëshkohet nga ERT-ja; - po kështu nuk u provua as pretendimi për interferencë valësh, por edhe nëse do të ekzistonte, ky kërkim nuk mund të ngrihet në një kohë që nuk është investuar paraprakisht ERT-ja (neni 9/g i rregullores).*

6. Me të njëjtin arsyetim, Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr. 213, datë 30.5.2007, ka vendosur: *Lënien në fuqi të vendimit nr. 210, datë 9.3.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.*

**D. Në lidhje me unifikimin e praktikës gjyqësore**

7. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se është e nevojshme të saktësohet dhe njësohet kuptimi i disa koncepteve ligjore mjaft të rëndësishme që i përkasin padisë dhe rolit të gjykatës në procesin gjyqësor civil. Kjo nevojë ka lindur për shkak të paqartësisë në praktikë dhe interpretimit jo të saktë të përcaktimeve të bëra në vendimin njësuës nr. 9, datë 9.3.2006 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke risqaruar dhe saktësuar rolin e gjykatës në procesin gjyqësor civil në lidhje me vlerësimin e objektit dhe shkakut të padisë.

8. Përpara Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë janë shtruar për zgjidhje çështjet që vijnë:

1. Cili është roli që duhet të luajë gjykata, veçanërisht në procesin e identifikimit të objektit të mosmarrëveshjes që duhet të shqyrtojë dhe të zgjidhë, pa cenuar të drejtën e disponimit të palëve që e kanë vënë atë në lëvizje?

2. A duhet të lidhet përgatitja dhe më pas gjykimi e zgjidhja e çështjes vetëm mbi atë që formalisht shkruhet dhe që në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë emërtohen si “objekt i padisë” dhe “baza ligjore”?

9. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se është e nevojshme të jepen paraprakisht disa konsiderata të përgjithshme në lidhje me pozitën e gjykatës në procesin gjyqësor civil. Ushtrimi i funksioneve gjyqësore është thelbësor për mirëfunksionimin e shtetit të së drejtës dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të personave.

10. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 7 të saj ka përcaktuar se “*Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënëse, ekzekutive dhe gjyqësore*”. Më tej, në nenin 135 (2) Kushtetuta përcakton se “*Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj*”. Sipas nenit 145 (2) të Kushtetutës “*Gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve*”. Cilësitë themelore të gjykatës në procesin gjyqësor civil përmbledhen në nenin 42 (2) të Kushtetutës, i cili parashikon se: “*2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetuese dhe ligjore ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj*”. Ky formulim i përgjigjet nenit 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.

10.1 Neni 42 (2) i Kushtetutës jep në vija të përgjithshme bazën që legjitimon personat e ndryshëm që t’i drejtohen gjykatës me padi. Kështu, sipas kësaj dispozite, padia mund të ngrihet në gjykatë për mbrojtjen e: 1) të drejtave; 2) lirive; dhe 3) interesave kushtetuese e ligjore. Detajimi i këtij parashikimi kushtetues gjendet në dispozitat përkatëse të së drejtës materiale dhe procedurale, por megjithatë nëse nuk ka dispozita të tilla, çdo person ka të drejtën t’i drejtohet gjykatës për mbrojtjen e të drejtave apo interesave që pretendon se i garantohen nga Kushtetuta, aktet ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë apo parimet e përgjithshme të së drejtës që zbatohen nga gjykatat shqiptare.

11. Pozita e gjykatës në procesin gjyqësor civil normohet konkretisht nga Kodi i Procedurës Civile (K. Pr. C.). Neni 1 i K. Pr. Civile përcakton se: “*Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë cakton rregulla të detyrueshme, të njëjta e të barabarta për gjykimin e mosmarrëveshjeve civile e të mosmarrëveshjeve të tjera të parashikuara në këtë Kod e në ligje të veçanta*”.

*Gjykata nuk mund të refuzojë, të shqyrtojë dhe të japë vendime për çështjet që i paraqiten për shqyrtim, me arsyetim se ligji mungon, nuk është i plotë, ka kundërthënie ose është i paqartë*”.

11.1 Gjykata, konform nenit 4 të K. Pr. Civile ka detyrimin të kujdeset për zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor. Për këtë qëllim, në bazë të kompetencave që i jepen nga K. Pr. Civile,



vendos për afatet dhe urdhëron marrjen e masave të nevojshme. Sipas nenit 14 të K. Pr. Civile “gjkata ka për detyrë që të zhvillojë një proces të rregullt ligjor, nëpërmjet garantimit të zhvillimit të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, në përputhje me ligjin”. Në këtë drejtim, konform nenit 15 të K. Pr. Civile “palët janë të detyruara të japin ndihmesën e tyre për zhvillimin normal të hetimit gjyqësor. Gjykata i ngarkon ato me përgjegjësi në rast mosveprimi ose pengimi me faj”.

12. Në nenin 2 (1) të K. Pr. Civile parashikohet shprehimisht se “vetëm palët mund të vënë në lëvizje gjykatën për fillimin e një procesi gjyqësor, përveç kur ligji parashikon ndryshe”. Gjithashtu, konform nenit 3 të K. Pr. Civile “kërkesa e palëve për fillimin e një procesi gjyqësor është e lidhur me përmbushjen nga ana e tyre të detyrimeve që rrjedhin prej këtij procesi, në format dhe afatet e parashikuara në këtë Kod”.

13. Procesi gjyqësor është veprimtaria ku ndërthuren të drejtat dhe detyrimet e subjekteve pjesëmarrëse në të, të cilat zakonisht janë tre: gjykata, paditësi dhe i padituri. Secili nga këto subjekte paraqitet si bartës të drejtash dhe detyrimesh procedurale, të cilat janë parashikuar shprehimisht në ligj, me qëllim zhvillimin e një procesi të rregullt gjyqësor. Neni 3 i K. Pr. Civile afirmon faktin se, që paditësi të mund të iniciojë një proces të rregullt gjyqësor, duhet të përmbushë disa formalitete të nevojshme. Përmbushja e këtyre formaliteteve nga paditësi synon të qartësojë për gjykatën, por edhe palën tjetër në gjykim, se çfarë kërkon paditësi me padinë që paraqet për gjykim. Pra, e drejta e padisë, që është e drejta e personit që bën pretendimin për t’u dëgjuar, mbi themelin e këtij pretendimi, në mënyrë që gjykata ta shpallë atë të bazuar apo jo, kushtëzohet me përmbushjen prej paditësit të disa formaliteteve të nevojshme. Këto formalitete procedurale ekzistojnë si garanci ndaj arbitraritetit, pasi e kanalizojnë gjykimin në hulli të mirëpërcaktuara. Ato janë garanci për palën e paditur, e cila ka të drejtë të dijë se përse është thirrur në gjykatë dhe se çfarë kërkohet prej saj nga paditësi.

13.1 Gjykata, në dallim nga pozita që ka pasur në kodet e procedurës civile të para viteve ‘90-të”, nuk ka të drejtë të ndihmojë aktivisht palët në formulimin e kërtimeve të tyre. Kjo është përgjegjësi e palëve, të cilat janë të lira të ndërtojnë mbrojtjen e interesave të tyre në gjykim, nëpërmjet përfaqësimit ose të çdo ndihme tjetër juridike, në përputhje me dispozitat në fuqi (neni 23 i K. Pr. Civile). Në këtë drejtim është miratuar edhe ligji nr. 10 039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike” (i ndryshuar), me qëllim që t’u vijë në ndihmë kategorive të personave në nevojë, të cilët nuk kanë mundësi të marrin ndihmë të kualifikuar juridike në mënyra të tjera.

14. Konform nenit 31 (2) të K. Pr. Civile, pala tjetër në gjykim ka të drejtë të diskutojë dhe të ngrejë prapësime mbi themelin dhe bazueshmërinë në ligj të pretendimeve të paditësit. Përmbushja e elementeve formale të paraqitjes së padisë në gjykatë është e nevojshme edhe për gjykatën, e cila nëpërmjet tyre vjen në dijeni të objektit dhe të dhënave të tjera të padisë, të cilat në fund ka detyrimin t’i shpallë të bazuara apo jo në ligj.

15. Duhet theksuar se legjislacioni ynë procedural e vendos barrën e përmbushjes së formaliteteve për fillimin e procesit gjyqësor te paditësi, me qëllim garantimin e fillimit të një procesi të rregullt, si dhe për të mbrojtur edhe të drejtat e të paditurit, të cilat mund të cenohen në rastin e paraqitjes së padive abuzive.

16. Fryma që karakterizon Kodin e Procedurës Civile është përcaktimi si rregull i një roli kryesisht pasiv për gjykatën (me përjashtime të mirëpërcaktuara, kryesisht sa i përket fazës së hetimit gjyqësor). Konform nenit 6 të K. Pr. Civile, gjykata, kur gjykon mosmarrëveshjet e ndryshme duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet. Gjykata e mbështet vendimin e saj vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor (neni 8 i K. Pr. Civile) dhe nuk vepron me iniciativë (*ex officio*) për hetimin e fakteve që nuk paraqiten nga palët në themel të pretendimeve të tyre. Nga ana tjetër, konform nenit 9 të K. Pr. Civile, gjykata ka të drejtë të ftojë palët për të dhënë shpjegime mbi faktet që ajo i vlerëson të nevojshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

16.1 Po ashtu, gjykata e mbështet vendimin e saj vetëm në mjetet, shpjegimet, dokumentet e provat e tjera të treguara ose të sjella nga palët, kur këto të fundit kanë qenë në gjendje të debatojnë sipas parimit të kontradiktorialitetit (neni 20 (2) i K. Pr. Civile). Më tej, në nenin 29 (1) të K. Pr. C. ritheksohet se gjykata e mbështet vendimin e saj në provat e paraqitura nga palët ose nga prokurori (kur ai ka ngritur padi), të marra në seancë gjyqësore. Këto dispozita të K. Pr. Civile parashikojnë, si rregull, rolin pasiv të gjykatës në procesin gjyqësor civil, me përjashtim të rasteve kur ligji në mënyrë të shprehur, me qëllim që t'i mundësojë gjykatës zhvillimin e një gjykimi të drejtë, i krijon asaj mundësi që të veprojë edhe kryesisht për saktësimin e fakteve objekt gjykimi.

17. Thelbi i sistemit tonë procedural civil lidhet me faktin se gjykata nuk merr iniciativën për të zgjidhur mosmarrëveshje të tjera, nga ato për të cilat palët i janë drejtuar gjykatës (dhe e mbështet vendimin në provat që paraqesin palët). Gjukata zgjidh mosmarrëveshjen që i paraqitet për gjykim duke vlerësuar nëse kërkimet e palës paditëse janë të mbështetura në ligj apo jo (neni 31 (1) i K. Pr. Civile).

17.1 Parimi i kontradiktorialitetit është një nga parimet bazë të procedurës civile dhe gjykata ka detyrim që ta ndjekë atë dhe të kërkojë zbatimin e tij. Zbatimi i parimit të kontradiktorialitetit duhet parë i lidhur ngushtë me parimin e disponibilitetit. Ky i fundit nënkupton se është paditësi ai që përcakton përmasat e mosmarrëveshjes që ka me të paditurin. Po ashtu i padituri, nëse ka mosmarrëveshje me paditësin, mund të paraqesë në gjykim kundërpadi, kur përmbushen kërkesat e nenit 160 të K. Pr. Civile. Kjo do të thotë se gjykata nuk ka iniciativë në zgjidhjen e çështjeve, për të cilat nuk është investuar nga palët, përveç rasteve kur ligji e parashikon shprehimisht një mundësi të tillë për gjykatën.

18. Pas parashtrimit të përgjithshëm të bërë më sipër, referuar çështjes së parë të shtruar për njësim të praktikës gjyqësore, se cili është roli që duhet të luajë gjykata, veçanërisht në procesin e identifikimit të objektit të mosmarrëveshjes që duhet të shqyrtojë dhe të zgjidhë, pa cenuar të drejtën e disponimit të palëve që e kanë vënë atë në lëvizje, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se gjykata ka detyrimin që t'i përmbahet objektit të padisë të parashtruar nga paditësi dhe të mos shprehet për pranimin ose rrëzimin e asaj që nuk është kërkuar në kërkesëpadi, përveç kur ligji parashikon të kundërtën. Kjo do të thotë se është paditësi ai që i kërkon gjykatës zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje të caktuar, duke parashtruar kërtime konkrete, të cilat në tërësinë e tyre formojnë objektin e mosmarrëveshjes. Gjukata pranon (qoftë edhe pjesërisht) ose rrëzon pretendimet e paditësit. Në rast se gjykata çmon se pretendimet e paditësit janë të pabazuara në ligj, ajo jep arsyet se përse ligji nuk mbështet kërkimin specifik të paditësit. Parimi i përputhjes midis asaj që kërkohet dhe asaj për të cilën shprehet gjykata është parim bazë i së drejtës procedurale civile, pasi nuk mund të ketë *ultra petita partium*.

18.1 Nga ana tjetër, gjykata nuk është e detyruar dhe e lidhur me cilësimin juridik që paditësi i bën mosmarrëveshjes, por duke qenë se e njeh vetë ligjin, bën cilësimin që ajo çmon për rastin konkret dhe jep zgjidhjen, bazuar në bindjen e saj të brendshme, të formuar nga gjykimi i çështjes konform ligjit, duke i gjetur të bazuara apo jo pretendimet e parashtruara në padi. Gjukata nuk e shkel parimin e përputhjes midis asaj që kërkohet dhe asaj që jepet, nëse bën një cilësim të ndryshëm juridik të fakteve të çështjes. Por nëse cilësimi juridik që gjykata u bën fakteve të çështjes, ndryshon nga shkak i padisë i përcaktuar në kërkesëpadi, gjykata nuk mund të anashkalojë një fakt të tillë dhe në këtë rast, vendos rrëzimin e padisë si të pambështetur në ligj. Kështu, gjykata, duke evidentuar kërkimin e paditësit dhe arsyet e këtij kërrimi (shkakun e padisë), që nuk i përgjigjen kërimit, çmon se pretendimet e paditësit janë të pambështetura në ligj, e në këtë rast rrëzon padinë. Gjukata nuk mund të anashkalojë shkakun e padisë, i parë në lidhje të ngushtë me objektin e padisë dhe të shprehet për diçka që nuk i është kërkuar (p.sh., nga padi rivendikimi që ka paraqitur paditësi, gjykata të shprehet për padi posedimore etj.).

19. Roli i gjykatës në identifikimin e objektit të mosmarrëveshjes paraqet rëndësi për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata. Kështu, në rastin e paraqitjes së një padie



të re, midis të njëjtave palë, gjykata, me kërkesën e palës së interesuar, do të bëjë atë që quhet “identifikimi i padive”, ku objekti i mosmarrëveshjes paraqitet si një element thelbësor për këtë identifikim (krahas palëve dhe shkakut të padisë). Në këtë rast, gjykata do të duhet të shqyrtojë elementet (*pretendimet*) përbërëse të objektit të mosmarrëveshjes (*padisë*) së zgjidhur më parë me vendim përfundimtar dhe t’i krahasojë ato me elementet e mosmarrëveshjes së re të paraqitur për shqyrtim. Në rast se gjykata do të konstatojë faktin se ato janë të njëjta, atëherë do të shprehet me vendim për rrëzimin e padisë për shkak të “*gjësë së gjykuar*”. E njëjta problematikë paraqitet edhe në rastin e litispencencës (gjyqvarësisë). Edhe në këto raste, gjykata do të duhet të bëjë “identifikimin e padive”, në mënyrë që të marrë një vendim të drejtë. Gjithashtu, “identifikimi i padive” shërben edhe për vlerësimin nëse pretendimet e reja të parashtruara nga palët në proces kanë lidhje të mjaftueshme me pretendimet e fillimit apo përbëjnë padi të re.

20. Në nenin 5 të Kodit të Procedurës Civile përcaktohet se: “*Objekti i mosmarrëveshjes përcaktohet në pretendimet e palëve.*”

*Pretendimet parashtrohen në aktin për fillimin e procesit gjyqësor, si dhe gjatë ushtrimit të drejtave që rrjedhin nga ky proces. Objekti i mosmarrëveshjes mund të ndryshojë sipas kërkesave që lindin gjatë procesit, kur këto të fundit kanë lidhje të mjaftueshme me pretendimet e fillimit.*

20.1 Kërkesat për ndryshimin e objektit të padisë rregullohen nga neni 185 (1) i K. Pr. Civile, i cili parashikon shprehimisht se: “*Paditësi gjatë hetimit gjyqësor ka të drejtë të ndryshojë shkakun ligjor të padisë. Ai, pa ndryshuar shkakun ligjor të saj, mund të shtojë, të pakësojë ose të ndryshojë objektin e padisë.*”

21. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se përcaktimi i objektit të mosmarrëveshjes që i paraqitet gjykatës për zgjidhje është në disponibilitetin ekskluziv të palëve dhe gjykata nuk mund të ndërhyjë në formulimin e tij. Janë palët ato që parashtrajnë kërkimet para gjykatës dhe që i kërkojnë asaj dhënien e një vendimi të caktuar (detyrimi, njohje apo transformues). Gjykata nuk ka të drejtë të dalë tej kërtimeve të palëve, që përbëjnë objektin e mosmarrëveshjes, pasi ajo zgjidh mosmarrëveshjen që i paraqitet për gjykim dhe nuk e zgjeron *ex officio* fushën e gjykimit.

21.1 Nga ana tjetër, gjykata, konform nenit 154/a të K. Pr. Civile, ka të drejtë të vlerësojë padinë *prima facie*, duke parë nëse ekzistojnë në dukje kushtet paraprake për ekzistencën e padisë (interesi, pranueshmëria hipotetike dhe mundshmëria juridike, si dhe legjitimitimi në dukje i palëve). Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se termat “objekt i mosmarrëveshjes” dhe “objekt i padisë”, të përdorura në mënyrë jokohërente në nenet 5 dhe 185 (1) të Kodit të Procedurës Civile, i referohen së njëjtës gjë. Ato janë tërësia e pretendimeve të bëra nga paditësi në padi, për të cilat gjykata duhet të shprehet me vendim (neni 31 (1) i K. Pr. Civile).

22. Referuar çështjes së dytë të shtruar për njësim të praktikës gjyqësore, se a duhet të lidhet përgatitja dhe më pas gjykimi e zgjidhja e çështjes vetëm mbi atë që formalisht shkruhet dhe që në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë emërtohen si “objekt i padisë” dhe “baza ligjore”, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se është e nevojshme të sqarohen termat që përdoren në Kodin e Procedurës Civile e që i korrespondojnë objektit të padisë dhe shkakut të saj.

23. Objekti i padisë (*petitum*) është ajo që kërkohet nëpërmjet paraqitjes së kërkesëpadisë në gjykatë dhe, që ka të bëjë me vendimmarrjen që i kërkohet gjykatës.

24. Siç u parashtrua edhe më sipër, objekti i mosmarrëveshjes përcaktohet në pretendimet e palëve. Në nenin 154 të K. Pr. Civile përcaktohet se: “*Kërkesëpadia shkruhet në gjuhën shqipe dhe duhet të përmbajë:*

- *Gjykatën përpara së cilës paraqitet kërkesa;*
- *Emrin, atësinë, mbiemrin, vendbanimin ose vendqëndrimin e paditësit e të paditurit dhe të personave që përkatësisht i përfaqësojnë ata, kur ka të tillë;*
- *Përcaktimin e objektit të kërkesëpadisë;*

- *Tregimin e fakteve, rrethanave, dokumenteve, mjeteve të tjera provuese dhe të së drejtës mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia;*

- *Kërkimin e paditësit;*

- *Vleftën e padisë, në rast se objekti i saj është i vlerësueshëm”.*

24.1 Neni 154 i K. Pr. Civile parashikon elementet e domosdoshme që duhet të përmbajë çdo kërkesëpadi. Në këtë nen përcaktohet se kërkesëpadia duhet të përmbajë “përcaktimin e objektit të kërkesëpadi” dhe “kërkimin e paditësit”. Të dy këto formulime i referohen së njëjtës gjë, që është objekti i mosmarrëveshjes. Formulimi i ndryshëm nuk ndryshon kuptimin e tyre. Objekti i padisë dhe kërkimet e paditësit përbëjnë ato që quhen “pretendime themeli të palëve” (në këtë rast të paditësit).

25. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se për të vlerësuar objektin e padisë është e nevojshme të shihet kërkesëpadia në përmbajtje të saj, të gjitha shtjellimet e kërkimet e paditësit dhe jo vetëm pjesa hyrëse e kërkesëpadi. Natyrisht që palët kanë detyrimin që të paraqesin pretendime të qarta dhe të kuptueshme për palën tjetër dhe gjykatën, por jo domosdoshmërisht objekti i padisë gjendet gjithnjë vetëm në pjesën hyrëse të kërkesëpadi (pavarësisht se në praktikë vërehet një konstante në këtë drejtim). Objekti i padisë përmbledh në vetvete të gjitha pretendimet e palës, të parashtruara në aktin procedural të kërkesëpadi. Ai mund të përmbajë një kërkim ose disa të tillë, ndaj kur vlerësohet se çfarë padie është paraqitur për gjykim, gjykatat nuk duhet të kufizohen vetëm te pjesa hyrëse e kërkesëpadi, por duhet të shohin tërësinë e përmbajtjes së saj. Kjo, pasi zakonisht në pjesën hyrëse të kërkesëpadi vendosen kërkimet bazë në formë të përmbledhur. Një pjesë e kërkimeve të padisë gjendet në pjesën përshkruese dhe shpjeguese të saj, e një pjesë tjetër mund të gjendet në pjesën fundore të kërkesëpadi.

25.1 Pala paditëse ka detyrimin të saktësojë kërkimet e saj ndaj të paditurit, por një gjë të tillë nuk ka detyrim ta bëjë domosdoshmërisht në mënyrë të plotë, në pjesën hyrëse të kërkesëpadi, por mund t'i fjalëzojë pretendimet në çdo pjesë të kërkesëpadi. Në këto kushte, si gjykata, ashtu edhe palët e tjera duhet të vlerësojnë me kujdes të gjithë kërkesëpadi, për të kuptuar objektin e saj dhe kërkimet apo pretendimet që paditësi ngre. Në të drejtën tonë procedurale civile zbatohet parimi i lirisë së formave të akteve procedurale dhe për këtë shkak paditësi nuk ka ndonjë detyrim që të ndjekë ndonjë rend në renditjen e elementeve të kërkesëpadi. Në praktikë përdoret zakonisht forma e parashtrimit të një pjese hyrëse në kërkesëpadi, ku shënohen gjeneralitetet e palëve, objekti i kërkimeve, dispozitat ligjore ku paditësi i mbështet kërkimet e tij, si dhe gjykata së cilës i drejtohen kërkimet. Më pas, vjen pjesa e shtjellimit nga paditësi të fakteve dhe rrethanave që e kanë lindur mosmarrëveshjen objekt gjykimi, provave që do të paraqesë dhe zakonisht në fund të kërkesëpadi riparashtrohen duke u renditur kërkimet specifike që i drejtohen gjykatës (p.sh. sigurim padie) dhe të paditurit (p.sh. detyrim pagim dëmshpërblimi në një shumë të caktuar).

25.2 Nëse kërkesëpadia paraqitet e errët në lidhje me atë që kërkohet me anë të saj, gjyqtari ka të drejtë, konform nenit 158/a të K. Pr. Civile, të kërkojë shpjegime nga pala paditëse, në mënyrë që të përcaktohet natyra e mosmarrëveshjes. Nëse, me gjithë këtë, objekti i padisë mbetet sërish i errët, gjykata ka të drejtë që konform nenit 154/a të K. Pr. Civile të kërkojë nga paditësi qartësimin e objektit të padisë, dhe nëse ky nuk vepron sipas urdhrave të gjykatës “... nuk plotëson të metat brenda afatit të caktuar, kërkesëpadia quhet se nuk është paraqitur dhe i kthehet paditësit së bashku me aktet e tjera”.

26. Sa i përket shkakut të padisë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë konstatojnë se në praktikë vihet re një paqartësi në lidhje me identifikimin e saktë të këtij koncepti juridik. Shkaku i padisë nuk është dispozita ligjore që shënohet në padi, por kjo e fundit shënohet për të bërë identifikimin e llojit të së drejtës që paditësi synon të mbrojë në gjykatë (parë në lidhje të ngushtë me objektin e padisë).



26.1 Subjektet e së drejtës mund të kenë mosmarrëveshje nga më të ndryshmet midis tyre. Këto mosmarrëveshje mund të kenë shkaqe të ndryshme, por procesi gjyqësor civil mund të iniciohet vetëm nëse paditësi ka një shkak të mbrojtur nga ligji për paraqitjen e padisë në gjykatë. Shkaku i padisë është kombinimi i faktit cenus dhe i së drejtës subjektive mbi të cilën bazohet padia e që ka lidhje me marrëdhënien juridike, që është themeli i pretendimit të paraqitur me kërkesëpadi në gjykatë. Shkaku i padisë nuk duhet ngatërruar me të ashtuquajturën “bazë ligjore” apo referenca ligjore që ndeshet në kërkesëpadi.

26.2 Shkaku i padisë përbëhet nga dy elemente: 1) e drejta subjektive, e cila gjen burimin e saj tek e drejta objektive; dhe 2) gjendja e faktit kundër kësaj të drejte (*causa petendi*). Për të kuptuar shkaku e padisë ndihmon edhe silogjizmi se norma juridike përbën premisën e madhe (parashikimin abstrakt të fakteve), faktet konkrete individuale përbëjnë premisën e vogël dhe lidhja midis këtyre të dyjave përbën marrëdhënien juridike nga ku rrjedh shkaku i padisë. Në këtë kuptim shkaku i padisë natyrisht që mbështetet edhe në një normë ligjore, pasi në të kundërt, nëse nuk do të mbështetej në ligj (*marrë në kuptimin më të gjerë*), atëherë padia do të ishte pa një shkak të ligjshëm. Pra, dispozita ligjore nuk është shkaku i padisë, pasi ky i fundit identifikohet duke e parë të lidhur me faktet e pretenduara që kanë cenuar të drejtën subjektive apo interesat e ligjshme të paditësit.

26.3 Shkaku i padisë, për sa i përket elementit përbërës të tij, që është e drejta subjektive, materializohet në një normë të caktuar juridike. Pretendimet e kërkesëpadiës nuk i drejtohen vetëm gjykatës (e cila është njohëse e ligjit), por edhe palës tjetër në gjykim. Parashtrimi i pretendimeve të qarta është mjaft i rëndësishëm për mbarëvajtjen e gjykimit. Për këtë arsye, në nenin 19 të Kodit të Procedurës Civile përcaktohet shprehimisht se: *“Palët duhet t’i bëjnë të njohura njëra-tjetrës, në kohën e duhur, mjetet dhe faktet mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre, provat që do të paraqesin dhe dispozitat ligjore që do t’u referohen, në mënyrë që të bëhet e mundur për secilën palë mbrojtja e interesave të tyre në gjykim”*.

26.4 Neni 19 i K. Pr. Civile hyn në kuadrin e dispozitave ligjore procedurale që rregullojnë parimin e kontradiktorialitetit, i cili është kusht *sine qua non*, për vlefshmërinë e procesit gjyqësor civil. Në nenin 42(1) të Kushtetutës përcaktohet shprehimisht se: *“liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor”*. Pjesë e pandarë e procesit të rregullt ligjor në procesin gjyqësor civil është respektimi i parimit të kontradiktorialitetit. Për këtë arsye, gjykatës i vendoset detyrimi që të ndjekë dhe të kërkojë të zbatohet parimi i kontradiktorialitetit (neni 20 (1) i K. Pr. Civile). Kjo do të thotë se gjykata është garantja e procesit që zhvillohet midis palëve kundërshtare dhe ajo mbikëqyr aktet procedurale që prodhohen gjatë gjykimit. Kërkesëpadi është një nga këto akte procedurale dhe, konform nenit 154 të K. Pr. Civile, paditësi ka detyrimin që në kërkesëpadi të përfshijë edhe *“tregimin e fakteve, rrethanave, dokumenteve, mjeteve të tjera provuese dhe të së drejtës mbi të cilat mbështetet kërkesëpadi”*. E drejta së cilës i referohet neni 154 i K. Pr. Civile është e drejta subjektive që pretendohet prej paditësit se është shkelur apo cenuar nga i padituri. Kjo e drejtë gjen pasqyrim tek e drejta materiale dhe për këtë shkak, paditësi ka detyrimin që ta identifikojë në kërkesëpadi të drejtën që kërkon të mbrojtë. Kjo, siç u tha më lart, paraqet rëndësi të veçantë për raportin e paditësit me të paditurin, në funksion të qartësisimit të kërkesëpadiës, për të cilën i padituri do të thirret në gjykatë që të japë shpjegime.

27. Në jo pak raste në praktikë “baza ligjore” e padisë, e cila shënohet në pjesën hyrëse të kërkesëpadiës, barazohet me shkaku e padisë, çka është e pasaktë. Baza ligjore në këtë rast është vetëm një nga elementet që shërben për të identifikuar të drejtën subjektive që paditësi kërkon të mbrojtë në gjykatë, duke shërbyer si pasqyrimi i së drejtës subjektive në të drejtën materiale. Sikurse është parashtruar më lart, shkaku i padisë përbëhet nga dy elemente, e drejta që kërkohet të mbrohet dhe faktet që bien ndesh me këtë të drejtë. Në këto kushte, kur në nenin 185 të K. Pr. Civile flitet për të drejtën e paditësit që të ndryshojë *“shkakun ligjor të padisë”*, kjo duhet kuptuar si ndryshim i 7660



referencës së paditësit jo vetëm në të drejtën materiale (si pasqyrim i së drejtës së tij subjektive që gëzon mbrojtje nga normat ligjore), por edhe në faktet e çështjes, në thelb të shkakut të padisë. Pra, në kuptim të kësaj dispozite, kur ndryshon “*shkaku ligjor*” i padisë, paditësi zgjedh të mos mbështetet më në titullin juridik (apo marrëdhënien juridike) fillestare, por e ndryshon atë, duke i bazuar pretendimet e tij të fillimit në një shkak tjetër ose thënë ndryshe në një titull juridik ose marrëdhënie juridike tjetër. Kjo shoqërohet njëkohësisht me referencën e re që paditësi bën në të dy elementet e shkakut të padisë dhe jo në vetëm njërin prej tyre.

27.1 Lidhur me këtë, vlen të theksohet se është tjetër aspekt çështja nëse shkak i padisë qëndron apo jo në rastin konkret, apo thënë ndryshe nëse përputhet objekti i padisë me shkakun e saj. Kjo çështje i përket gjykimit të themelit, gjatë të cilit gjykata do të marrë në shqyrtim provat e paraqitura nga palët, me qëllim provimin e fakteve me rëndësi për çështjen. Paditësi afirmon se ka një të drejtë të garantuar nga ligji (*si dhe faktin krijues të së drejtës*) dhe se i padituri ka mbajtur një sjellje të tillë që bie ndesh me këtë të drejtë, ndaj për këtë shkak kërkon nga gjykata marrjen e një vendimi të caktuar kundër të paditurit. I padituri, pasi merr dijeni për pretendimet e paditësit, ka të drejtë të debatojë e të prapësojë vetëm brenda objektit të gjykimit dhe nëse do t’i shtrijë pretendimet edhe më tej, ka të drejtë që brenda kushteve të nenit 160 të K. Pr. Civile të paraqesë kundërpadi në të njëjtin gjykim.

28. Referuar sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se përgatitja dhe gjykimi, e zgjidhja e çështjes nuk mund të bazohet vetëm mbi atë që formalisht shkruhet në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë e që emërtohen “objekti i padisë” dhe “baza ligjore” e saj. Gjykata kur zgjidh mosmarrëveshjen merr në shqyrtim pretendimet e paditësit, të cilat parashtrihen në kërkesëpadi, si dhe gjatë ushtrimit të të drejtave që rrjedhin nga procesi, duke mbajtur parasysh se konform neneve 5, 31, 154 e 185 të K. Pr. C., objekti i padisë dhe shkak i saj nuk përmbledhen domosdoshmërisht vetëm në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë. Gjykata ka detyrimin të vlerësojë dhe të marrë parasysh të gjithë përmbajtjen e padisë dhe të identifikojë kërkimet e paditësit, në mënyrë që të mund të japë një vendim për to. Pala paditëse ka të drejtë të ngrejë pretendime për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave që i njejn Kushtetuta apo ligji, ndërsa gjykata, në zbatim të parimit *iura novit curia*, analizon ligjërisht në mënyrë të pavarur këto pretendime, pa u lidhur me përcaktimin e palëve. Nëse gjykata konstaton se pretendimet e paditësit, d.m.th. objekti i padisë dhe shkak i saj gjejnë mbrojtje ligjore, atëherë e pranon padinë, në rast të kundërt padia rrezohet.

29. Sa më sipër ndodh për shkak se një fakt i caktuar mund të sjellë lindjen e shumë marrëdhënieve juridike të njëkohshme apo të njëpasnjëshme. Marrëdhëniet juridike në fjalë qëndrojnë në themel të shkakut të padive respektive që mund të ngrihen nga subjektet pjesëmarrëse të këtyre marrëdhënieve juridike. Objekti i padisë ose kërkitimi që i kundrejtohet palës kundërshtarë mund të jetë i njëjtë në disa padi, por ato dallojnë nga njëra-tjetra, sepse bazohen në shkaqe të ndryshme juridike. Për këtë arsye, i takon paditësit të parashtrijë në gjykatë se mbi cilin shkak i mbështet pretendimet e tij, duke saktësuar të drejtat konkrete që ai kërkon të mbrojtë me anë të padisë. Në këtë kuptim, **gjykata e zbulon shkakun e padisë së paditësit duke e analizuar padinë në tërësinë e saj dhe jo duke u kufizuar te dispozitat ligjore të referuara nga paditësi në pjesën hyrëse të saj. Mund të ndodhë që paditësi të referojë gabimisht dispozitat ligjore, porse nga leximi i kërkesëpadisë del e qartë e drejta që ai kërkon të mbrojtë. Në këtë rast, gjykata duhet të zgjidhë çështjen konform shkakut që rezulton nga shqyrtimi në tërësi i kërkesëpadisë, duke bërë lidhjen midis fakteve që pretendohen prej paditësit se kanë ngjarë dhe të drejtave apo interesave që ai pretendon se i janë cenuar.** Për këtë arsye, në nenin 17 të K. Pr. Civile, është parashikuar e drejta e gjykatës që të ftojë palët që të japin shpjegime nga pikëpamja e së drejtës që ajo e çmon të nevojshme për zgjidhjen e çështjes. Gjatë dhënies së këtyre shpjegimeve, palët kanë mundësi të qartësojnë dhe saktësojnë edhe ndonjë mospërputhje rastësore në referencat ligjore.





30. Në nenin 16 të K. Pr. Civile përcaktohet se: “Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj. Ajo bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët.

*Megjithatë, gjykata nuk mund të ndryshojë bazën juridike të padisë pa kërkesën e palës”.*

30.1 Siç është theksuar edhe më lart, mosmarrëveshja i sillet gjykatës për zgjidhje me anë të ushtrimit të së drejtës së padisë nga paditësi. Padia është e drejta e personit që bën pretendimin për t’u dëgjuar, mbi themelin e këtij pretendimi, në mënyrë që gjykata ta shpallë atë të bazuar apo jo (neni 31 (1) i K. Pr. Civile). Pra, gjykata analizon pretendimet e paditësit, d.m.th. shikon nëse ka lidhje objekti i padisë me shkakun e saj (dhe sigurisht edhe faktet e provuara gjatë gjykimit) dhe në fund e shpall të bazuar ose jo padinë. Themeli i pretendimit formulohet nga palët dhe gjykata ka detyrimin që të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet (neni 6 i K. Pr. Civile).

31. Në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, gjykata paraqitet në rolin e një arbitri asnjës, i cili vlerëson në mënyrë të paanshme pretendimet e palëve dhe në fund i shpall ato të bazuara apo jo. Palët kanë të drejtë të parashtrorjnë para gjykatës interpretimin apo përcaktimin e tyre për faktet dhe të drejtat që lidhen me zgjidhjen e çështjes, por gjykata në ushtrim të pavarësisë dhe paanësisë së saj, i çmon vetë këto çështje, e nëse i gjen të bazuara pretendimet e palëve, i pranon, në të kundërt i rrëzon. Parimi *iura novit curia*, në këtë rast, do të thotë se gjykata nuk i merr si të mirëqena shpjegimet e palëve në lidhje me zbatimin e ligjit për çështjen konkrete, por si njohëse e ligjit, e zgjidh vetë mosmarrëveshjen, sipas formimit dhe bindjes së saj të brendshme, të bazuar në kriteret që parashikon Kushtetuta, Kodi i Procedurës Civile dhe ligjet e veçanta. Po ashtu, gjykata nuk lidhet as me përcaktimin që palët mund t’i bëjnë fakteve të çështjes, ndonëse ka detyrimin, konform nenit 10 të K. Pr. Civile, që të mbështesë vendimin e saj vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit. Gjykata vërtet e mbështet vendimin të faktet e paraqitura gjatë gjykimit, por vlerësimin e tyre e bën në mënyrë të pavarur, d.m.th. nuk i merr të mirëqena përcaktimet e palëve, por pasi analizon provat e marra gjatë gjykimit, e vlerëson vetë ekzistencën e fakteve me rëndësi për zgjidhjen e çështjes. Gjykata, madje ka të drejtë që të ftojë palët për të dhënë shpjegime mbi faktet që ajo i vlerëson të nevojshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes (neni 9 i K.Pr.C.). Pra, gjykata nuk lidhet me përcaktimin që bëjnë palët në lidhje me faktet apo me ligjin që zbatohet për këto fakte.

32. Megjithatë, gjykata nuk mund të ndryshojë bazën juridike të padisë pa kërkesën e palës, që në rastin konkret është paditësi.

32.1 Pamundësia e gjykatës për të ndryshuar bazën juridike të padisë konform nenit 16 (2) të K. Pr. Civile duhet vlerësuar si kufizim ligjor që përputhet me parashikimet e neneve 6, 10, 14, 20 (2), 28, 31 dhe 185, e që ka të bëjë me ndalimin që gjykata të shprehet për diçka që nuk i është kërkuar. Në këtë rast, gjykata mban parasysh se që të pranohet padia (qoftë edhe pjesërisht) duhet që të ketë lidhje midis objektit dhe shkakut të saj, e nëse një gjë e tillë nuk ndodh, atëherë padia rrëzohet. Gjykata ka të drejtë të vlerësojë në mënyrë të pavarur elementet e shkakut të padisë (faktin dhe të drejtën), por këtë e bën në kuadër të verifikimit të përputhshmërisë së kërkimit të paditësit me ligjin. Kjo pasi është paditësi ai që merr iniciativën për fillimin e procesit gjyqësor civil dhe gjykata ka detyrimin të gjykojë çështjen me pavarësi dhe paanësi, duke u shprehur vetëm për atë objekt mosmarrëveshje dhe për atë shkak ligjor që paditësi parashtron para saj.

#### **E. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes, objekt gjykimi**

33. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër dhe ajo e Apelit Gjirokastër nuk e kanë zgjidhur drejt mosmarrëveshjen e parashtruar nga paditësja me padi. Gjykata e rrethit shprehet se paditësja nuk ka referuar te ligji “Për pronësinë industriale”, kur në fakt ajo e ka përcaktuar qartë të drejtën e saj subjektive, të pretenduar si të cenuar dhe, edhe pa iu referuar ligjit në fjalë, është e qartë se çfarë kërkon dhe ku e mbështet pretendimin e saj.

34. Dispozitat përkatëse të Kodit Civil nxjerrin në pah llojin e së drejtës subjektive që paditësja kërkon të mbrojë në gjykatë dhe i takon kësaj të fundit që të vlerësojë bazueshmërinë e tyre në ligj, jo duke bërë një mbivendosje formale, midis asaj që kërkohet dhe “bazës ligjore” të vendosur në padi, por duke vlerësuar me kujdes natyrën e mosmarrëveshjes dhe duke i dhënë zgjidhje asaj. Nuk mund të jetë argument për rrëzimin e padisë referenca e paplotë në ligj, kur paditësja e ka qartësuar mjaftueshëm të drejtën që kërkon të mbrojë në gjykatë dhe kjo del qartë nga përmbajtja e padisë. Referenca ligjore nuk është shkaku i padisë. Në këtë rast, shkaku i padisë është mjaftueshmërisht i qartë dhe lidhet me faktet e pretenduara si cenues prej paditëses për të drejtat e saj konform neneve 638, 639 e 608 të Kodit Civil. Për këtë arsye, gjykata duhet të japë vendim nëse pretendimi është i mbështetur në ligj apo jo dhe jo të merret me referencën e munguar ligjore të paditëses. Gjykata në zgjidhjen e çështjes zbaton legjislacionin në fuqi që është i detyrueshëm për të dhe këtë e bën pasi është qartësuar mjaftueshëm në lidhje me pretendimet e palëve.

35. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se rrëzimi i padisë së paraqitur nga ana e paditëses me arsyetimin e referencës së gabuar ligjore është bërë në zbatim të gabuar të ligjit.

36. Për sa më sipër, lidhur me zgjidhjen e çështjes objekt gjykimi, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se vendimi nr. 213, datë 30.5.2007 i Gjykatës së Apelit Gjirokastër dhe vendimi nr. 210, datë 9.3.2007 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër nuk gjejnë mbështetje në ligj, dhe si të tillë duhet të prishen dhe çështja të dërgohet për rigjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, me tjetër trup gjykues.

#### PËR KËTO ARSYE,

Në mbështetje të nenit 141, paragrafi i 2 i Kushtetutës së Shqipërisë, nenit 17, germa “a” dhe 19 të ligjit nr. 8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, si dhe të nenit 485, germa “ç” të Kodit të Procedurës Civile, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë

#### VENDOSËN:

Prishjen e vendimit nr. 213, datë 30.5.2007 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër dhe vendimit nr. 210, datë 9.3.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, me tjetër trup gjykues.

Ky vendim është njësuës dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Besnik Imeraj (kryesues), Gani Dizdari, Ardian Dvorani, Fatos Lulo, Ardian Nuni, Arjana Fullani, Majlinda Andrea, Guxim Zenelaj, Aleksandër Muskaj, Andi Çeliku, Evelina Qirjako, Mirela Fana, Medi Bici, Edmond Islamaj, Shkëlzen Selimi

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2013

Çmimi 20 lekë